



**INSTITUTI
HIDROMETEOROLOGJIK
I KOSOVËS**

Sektori i Hidrologjisë dhe Prognozave Hidrologjike

Prishtinë
21/01/2023

Elaborat

**VËSHTRIM HIDROLOGJIK – DHE
METEOROLOGJIK**
(Situata me përmbytje)

Periudha:
17 - 21/01/2023

Autor:
Dr. Bashkim Kastrati

Për:
Agjencinë e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës (AMMK)

© Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës (MMPHI)
Agjencioni Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës (AMMK)
Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK)

E drejta e publikimit në formë të shtypur, elektronike dhe në ndonjë formë tjetër dhe në çdo gjuhë është e rezervuar nga MMPHI dhe autori. Ekstrakte të shkurtra nga publikimet e IHMK mund të riprodhohen dhe shkëmbehen pa autorizim, me kusht që burimi i plotë të tregohet qartë. Korrespondenca editoriale dhe kërkesat për të publikuar, riprodhuar ose përkthyer këtë dokument pjesërisht ose tërësisht duhet të adresohen në:

MMPHI
Ish pallati i mediave "Rilindja". Katet: XIV XV-XVI-XVII

AMMK
Ish pallati i mediave "Rilindja", *Kati XV/04*
10000, Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: 038 200 33 228 & 038 200 33 233
Email: ammk@rks-gov.net


IHMK
St.Lidhja e Pejës,nr.47
10 000. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 38 603 842; +381 38 603 179
e-mail: ihmk@rks-gov.net
Mob: +383 (0) 44 25 65 52

Autori:
Dr. Bashkim Kastrati
Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
Mob: +383 44 25 65 52
E-mail: bashkim.kastrati@rks-gov.net

SITUATA METEOROLOGJIKE

Duke filluar nga datë.16/01/2023, kur masa ciklonike e kishte përfshirë edhe vendin tonë, duke sjellur sasi të reshjeve fillimisht me intensitet të ulët deri mesatarë, kryesisht në pjesën perëndimore të Kosovës, ndërsa gjatë datave: 17-18-19/01/2023, ato u shtuan në intensitet më të lartë, duke u zgjeruar edhe në pjesën veriore dhe veriperëndimore të vendit, ku si pasojë e tyre, sistemet lumore të pellgut të Drinit të Bardhë (Bistrica e Pejës, Deçanit, Ereniku, Lumi Istogut, Klina, Mirusha etj.), pastaj lumi i Ibri, me degët e tij, kryesisht ato me karakter malorë dhe disa prej tyre në formë të rrëkeve, u formuan shumë shpejtë duke pasur potencial të lartë vërshues, me bartje të sedimenteve, krijim të erozionit, rrëshqitje të dherave, ku si pasojë, sidomos në pjesët e poshtme të tyre shkaktuan vërshime të shpejta e më pas edhe përmbytje lumore.

Fig. 1 Situata me reshje në Kosovë me 18/01/2023



Zonat më të goditura të përfshira në përmbytje në pellgun e Drinit të Bardhë janë vendbanime dhe qytete si në komunën e Gjakovës, Juniku, Pejës, Istogu, Klinës, e posaqërisht më e përfshira nga këto përmbytje ishte Skenderaj nga lumi Klina. Ndërsa në pellgun e Ibrit, vërshimet janë shkaktuar më së tepërmi në Mitrovicë, ngase ajo zonë ka karakteristika të veçanta hidologjike dhe hidrografike, ku gravitojnë një numër i lumenjve, nga të dyja anët e tij, po ashtu më pjesën perëndimore ndodhet edhe Liqeni i Ujmanit (më i madhi në Kosovë), i cili mbushet nga lumi i Ibrit, i cili burim e tij e ka në pjesën e Alpeve Shqiptare, e cila gjatë këtyre ditëve ishte e përfshirë me reshje të intensitetit të lartë, duke pasur prurje të mëdha të ujit të cilat futeshin në liqe, prandaj sipas të gjitha gjasave, portat e digës së Ujmanit janë hapur për shkaqe të sigurisë së digës, ndërsa në të kundërtën në rrjedhën e lumit të Ibrit poshtë sajë në Mitrovice, aty ku bashkohen edhe lumenjtë: Sitnica, Lushta etj, u shkaktuan përmbytje masive.

SITUATA HIDROLOGJIKE

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, përmes sektorit të Hidrologjisë, disa ditë më herët (dt. 16/01/2023), me shkrim/njoftim dhe zyrtarisht, i ka informuar institucionet kompetente të shtetit (Agjencionin e Menaxhimit të Emergjencave), përmes së cilës janë informuar Qendrat Operative në nivel të Komunave, konkretisht të atyre të cilat janë përfshirë në përmbytje dhe të njëjtat i ka mbajtur të informuar me situatën e përgjithshme hidrometeorologjike. Këtë e ka bërë, përmes rrjetave të saja monitoruese nga stacionet Meteorologjike dhe të reshjeve si dhe atyre hidrometrike të shtrira në tërë territorin e Kosovës. Informata në kohë reale, janë marrë nga rrethë 12 stacione automatike Meteorologjike dhe nga 8 hidrometrike. Të dhënat meteo janë marrë për sasinë totale të reshjeve sipas kohës, ndërsa për nivelet e ujit në shumicën e këtyre stacioneve online në interval çdo 15m dhe 1h. Shumica e lumenjve kryesore në nivel të vendit, i kanë të krijuara të ashtuquajtur “Profilin e tërthorta”, përmes të cilave janë të përcaktuara pragjet e vërshimeve. Të gjitha këto informacione janë rifreskuar çdo ditë nga disa herë, në mënyrë që informacionet e ofruara për qytetarë të jenë të sakta dhe në kohën e duhur. <https://ihmk-rks.net/?page=1,50>

Figura 1 Profili i tërthorët në lumin Ibri në Leposaviç




Tabela 1 Sasia e reshjeve (mm = l/m²), sipas disa stacioneve meteorologjike/reshjeve

Kodi	Vendi	Lm.n.d.A	Sasia e reshjeve në mm 17 – 20/01/2023
MS_01A	Prishtinë	573	27.5
MS_02A	Prizren	389	32.4
MS_03A	Pejë	501	136.4
MS_04A	Ferizaj	578	18.6
MS_06A	Shajkoc	632	39.8
MS_07A	Dragash	1048	33.3
3MS_08A	Junik	618	234.1
MS_10A	Kamenicë	474	17.3
MS_12A	Istog	464	112.6
MS_13A	Malishevë	556	51.2
MS_14A	Gjakovë	467	49.1
RG15_01	Mitrovicë	458	95.2

Siq shihet nga tabela (1), gjatë këtyre ditëve, sasia më e lartë e reshjeve të shiut është regjistruar në Junik 234.1 mm, pastaj Pejë 136.4, Istog 112.6 etj.

Sa i përket niveleve të ujit nëpër disa prej lumenjve kryesorë të Kosovë, gjatë kësaj periudhe vërshuese, mund të konstatohet se lumi Drini i Bardhë, në dy profile hidrometrike, Gjonaj dhe Këpuz, ka regjistruar nivelet dhe prurjet më të larta, të cilat i kanë tejkaluar pragjet e lejuara, prandaj kanë shkaktuar edhe përmbytje nëpër disa zona të caktuara.

Tabela 2 Nivelet e lumenjtë kryesorë të Kosovës, sipas Stacioneve Automatike Hidrologjike, gjatë ditëve me përmbytje dhe tendencat e tyre


Kodi	Lumi	Stacioni	Nivli i ujit (m)				
			17/01/2023 7:00	18/01/2023 7:00	19/01/2023 7:00	20/01/2023 7:00	21/01/2023 7:00
RB1_S01O	Drini Bardhë	Gjonaj	2.327	3.640	4.873	6.535	6.452 ↔
RB1_S02O	Drini Bardhë	Këpuz	1.453	2.721	4.143	6.311	3.772 ↓
RB1_S05O	Bistrica Pejës	Grykë e Rug,	0.762	1.708	1.694	1.489	↓
RB2_S01O	Ibri	Leposaviç	1.771	2.011	2.980	5.420	5.029 ↓
RB2_S02O	Ibri	Mitrovicë	0.784	0.836	1.585	2.543	2.685 ↑
RB2_S04O	Sitnica	Nedakoc	1.687	1.988	2.117	2.594	3.117 ↑
RB3_S01O	Morava B.	Konçul	2.366	2.496	2.546	3.086	3.311 ↑
RB4_S01O	Hani Elezit		0.740	0.759	0.783	0.917	0.899 ↔

Sqarim: ↔ Stagnim ↑ ngritje, ↓ rënie

Vlerat më të larta të niveleve, janë regjistruar gjatë datës 20/01/2023, në të gjithë lumenjtë, e cila përputhet me sasinë e reshjeve të rënë në pellg gjatë ditës paraprake, e cila ka shkaktuar përmbytjet.

Aktualisht lumenjtë të cilët kanë karakter fushorë, siç janë rrjedha e poshtme e Drinit të Bardhë, Sitnica, Ibri në rrjedhën pas digës së Ujmanit, Morava e Binçës dhe Lepnci, kanë një ngritje të letë, e cila është e kuptushme, ngase është duke u kulluar pellgu, përmes rrjedha ujore,

Figura 3 Situata meteorologjike gjatë ditëve në vijim



Parashikimi për ditët në vijim

Edhe gjatë ditëve në vijim, deri më datë 25/01/2023, pritet që në territorin e Republikës së Kosovës të vazhdojnë reshjet atmosferike, të cilat nëpër disa zona mund të shkaktojnë probleme me vërshime, dhe vështërsi, sidomos nëpër zonat gjagjesisht komunat të cilat deri me tani ishin me të prekurat prej tyre.

KONKLuzion

Paraqitja e vërshime, fillimisht të shpejta, e më pas edhe përmytjeve lumore, të cilat çdo vit po bëhen me të shpeshta dhe më shkatërruese, vinë si pasojë e një mori të faktorëve. Vlen të potencohet se një përmytje masive, tek ne është shume e freskët, ngase gjatë muajit Janar të vitit 2021, kishim një ngjarje të tillë me periudhe kthyesë 50 vj. E afërsisht, duke u bazuar në të dhënat e deritanishme, mund të konstatojmë që edhe kjo përmytje gjatë këtyre ditëve ishin të përmasave afërsisht të njëjta, ndërsa në disa zona edhe e kanë tejkaluar atë.

Faktori i Ndryshime Klimatike është i pakontestueshëm, ngase, stuhi të tilla me karakter ciklonik, të përcjellura me rreshe të shiut, po bëhen gjithnjë e më të shpeshta, sidomos gjatë muajve të dimrit, kur zakonisht do duhej të kishte shtresë të borës. Gjatë muajit janar 2023, janë regjistruar temperature të larta, si në vlerat e tyre mesatare edhe në ato absolute, që janë pak sa të pa zakonit për këtë periudhë.

Vërejtje:

Reshesh më të larta se 30 l/m² në 12 orë shkaktojnë vërshime, probleme në të gjitha aktivitetet e prodhimit bujqësor, probleme në trafik, rrezik për rrëshqitje dheu. Lëndime të mundshme të njerëzve dhe dëmtim të pronës


Sqarim: Prodhimi i këtij informacioni të jashtëzakonshëm meteorologjik dhe hidrologjik, bazohet në modele të certifikuara dhe prognoza profesionale zyrtare. Produktet e qendrës Evropiane të Parashikimit të Motit ECMĒF të Sistemit Evropian Copernicus – EFAS dhe ICON –KS, model i krijuar nga shërbimi kombëtar gjerman i motit (DWD Deutscher Wetterdienst).

Njoftimet nga IHMK, gjatë këtyre ditëve:


<https://ihmk-rks.net/?page=1,1>

1. 16 Janar 2023 “Njoftim”
https://ihmk-rks.net/uplds/docs/Njoftim_per_vershime_16.01.2022_01.pdf
2. 19 Janar 2023 “Njoftim”
https://ihmk-rks.net/uplds/docs/Situata_Hido_Meteo_19.01.2023_Nr_02.pdf
3. 19 Janar 2023 “Njoftim me të dhënat më të fundit Hidrometeorologjike dhe këshillat dhe veprimet të cilat duhen të merren gjatë një përmbytje”
https://ihmk-rks.net/uplds/docs/Situata_Hido_Meteo_19.01.2023_Nr_03.pdf
4. 20 janar 2023 “Njoftimi me të dhënat e fundit nga IHMK
https://ihmk-rks.net/uplds/docs/Situata_Hido_Meteo_20.01.2023_Nr_04-1.pdf

RRJETI SHITETËRORË METEOROLOGJIK



RRJETI I STACIONEVE HIDROMETRIKE TË KOSOVËS - 2021



Legjenda

	St_Hidrologjik		Rrjedhë ujore Lumë		Liqe artificial		Kufiri i Kosovës
	St_Hidro_Online		Lumë kryesorë				Kufi pellgu lumorë

© Dr. Bashkim Kastrati

